



BASHKIA FUSHË - ARRËZ
Nr. 2023 prot. Dt. 16.8.25
Ref: Këshilli

Nr. 531/1 Prot.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Shkodër, më 2.08.2025

Lënda: Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 32, datë 27.08.2025.

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8 germa a, neni 16, Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 5.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 18, neni 24, 25, neni 54/k, neni 55/3, neni 64 germa c, ligj nr.9970/2008 "Për barazinë gjinore", Urdhërit të Prefektit për delegim Nr.62, datë 28.08.2025, shkresës së sekretarit të KB nr.2320/1 prot datë 04.09.2025, shqyrtoi Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 32, datë 27.08.2025 "Mbi miratimin e planit vendor për barazinë gjinore për vitet 2025-2027".

Për sa trajtuar, referuar Urdhërit të Prefektit për delegim Nr.62, datë 28.08.2025, ju autorizohet procedim i mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Majlinda ANGONI

NË MUNGESË DHE DELEGIM

NËNPREFEKTI
Hysen HYSAJ



437



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2660 prot.

Fushë-Arrëz, më 2.09.2025

VENDIM

Nr. 32, datë 27.08.2025

“PËR

**MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR BARAZINË GJINORE 2025-2027 PËR
BASHKINË FUSHË-ARRËZ”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Vendimit nr. 400, datë 30.6.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimt”. Ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr. 125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 124/2020 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10221/04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Ligjit Nr. 35/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligjit Nr. 136/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”; Ligjit Nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 101/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr. 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijes”, Ligji Nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, Ligji Nr. 111/2017 Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” i ndryshuar, Ligji Nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 7905, datë 21.03.1995. “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, Ligji Nr. 79/2017 “Për sportin”, Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë” i ndryshuar; Relacionit të hartuar nga Sektori për Çështjet Sociale me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 27.08.2025, pasi shqyrtoi materialin e hartuar nga grupi i punës dhe dëgjoi shpjegimet e specialistëve të fushës përkatëse,

VENDOSI

1. Të miratojë Planin Vendor për Barazinë Gjinore 2025-2027 për Bashkinë Fushë-Arrëz, sipas Planit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Migracionit, Diasporës, Projekteve Sociale si dhe sektorët e tjerë ndëreveprues.

3. Ky vendim u zbardh me datë 2.09.2025 dhe hy në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak Fushë-Arrëz me:

9 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU





PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025 - 2027

MIRATUAR ME VENDIMIN NR.32, DATË 27.08.2025 TË KËSHILLIT BASHKIAK
FUSHË-ARRËZ

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2027 u përgatit nga Bashkia Fushë-Arrëz me mbështetjen e të gjithë stafit të Bashkisë:

Grupi i punës:

1. Mikel Qafa, Nënkrjetari i Bashkisë, Kryetar
2. Gjok Nikolli, Shef Kabineti, Anëtar
3. Sidorela Katroshi, Drejtor i Shërbimit Social, Anëtare
4. Klotilda Curri, Përgjegjëse e Çështjeve Sociale, Anëtare
5. Lindita Lleshi, Specialiste e Çështjeve Sociale, Anëtare
6. Daniela Ymeri, Psikologe, Anëtare
7. Fatjona Selimaj, Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore
8. Redona Hasani, Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, Anëtare
9. Altin Engjelli, Specialist i Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Anëtar
10. Dritan Lika, Drejtor, Drejtoria e Financave, Anëtar
11. Elis Miriaj, Specialist i Sektorit të Integrimit Evropian

Fjalë nga Kryetari i Bashkisë

Të nderuar qytetarë,

Me kënaqësi ju paraqes Planin e Barazisë Gjimore të Bashkisë sonë, një dokument strategjik dhe vizionar që synon të garantojë të drejta dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat në të gjitha fushat e jetës. Ky plan është fryt i një procesi gjithëpërfshirës, ku janë angazhuar jo vetëm strukturat e bashkisë, por edhe organizatat e shoqërisë civile, përfaqësues të komunitetit dhe partnerë të ndryshëm institucionalë.

Barazia gjimore është një nga vlerat themelore mbi të cilat ndërtohet një shoqëri demokratike dhe e drejtë. Ajo nuk nënkupton vetëm respektimin formal të të drejtave, por krijimin e një mjedisi ku secili individ, pavarësisht gjinisë, të ketë mundësinë të zhvillohet, të kontribuojë dhe të përfitojë në mënyrë të barabartë. Përmes këtij plani, Bashkia jonë angazhohet të forcojë rolin e grave dhe vajzave në jetën politike, ekonomike dhe sociale, të garantojë përfaqësimin e tyre në vendimmarrje, si dhe të sigurojë shërbime publike më të drejta dhe më cilësore për të gjithë qytetarët.

Ky dokument është dëshmi e përkushtimit tonë për të ndërtuar politika dhe programe që nuk mbeten vetëm në letër, por që ndikojnë realisht në përmirësimin e cilësisë së jetës. Jam i bindur se zbatimi i tij do të ndihmojë në fuqizimin e grave dhe burrave, në rritjen e pjesëmarrjes së tyre aktive dhe në krijimin e një komuniteti më gjithëpërfshirës, më solidar dhe më të barabartë.

Dua të falënderoj të gjithë ata që kontribuan me përkushtim, ide dhe mbështetje në hartimin e këtij plani. Ky është një hap i rëndësishëm drejt një të ardhmeje ku barazia gjimore nuk është vetëm aspiratë, por realitet i prekshëm për të gjithë. Bashkia jonë mbetet e vendosur që ta kthejë këtë plan në një udhërrëfyes të punës sonë të përditshme dhe në një instrument konkret për zhvillimin social e ekonomik të komunitetit.

Me respekt,
Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz
Hil CURRI

LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE

AGK	Aleanca e Grave Këshilltare
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHF	Dhuna në Familje
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisiplinar (për rastet e dhunës në familje)
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve)
KB	Këshilli Bashkiak
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGJ	Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore
NJA	Njësi Administrative
NJVKSH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Jo-Fitim-Prurëse
ON	Organizatë Ndërkombëtare
OS	Objektiv Specifik
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PVVBGJ	Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030)
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

Table of Contents

<i>Fjalë nga Kryetari i Bashkisë</i>	<i>3</i>
<i>LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE</i>	<i>5</i>
<i>I. HYRJE</i>	<i>6</i>
<i>II. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL.....</i>	<i>7</i>
<i>III. METODOLOGJIA.....</i>	<i>9</i>
<i>IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHRYJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË</i>	<i>12</i>
<i>KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2025 - 2027</i>	<i>16</i>
<i>VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI.....</i>	<i>17</i>

I. HYRJE

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 - 2027 u përgatit nga Bashkia Fushë-Arrëz, si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore.

Ky plan veprimi u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore shtator 2025 – shtator 2027, është një dokument i cili shërben si udhërrëfyes i parë për fillimin e punës për zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri më të vërtetë e të barabartë.

Ky plan ka rëndësi themelore pasi shënon një standart të ri për qasjen institucionale ndaj barazisë gjinore në Fushë-Arrëz, duke formalizuar për herë të parë këtë angazhim me një dokument të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Ai shërben si një mjet praktik për të koordinuar veprimet ndërsektoriale, për të fuqizuar mekanizmat vendorë si Komisioni për Barazinë Gjinore apo Mekanizmi i Koordinuar i Referimit, si dhe për të siguruar pjesëmarrje më të gjerë në vendimmarrje të grave, të rejave dhe grupeve të tjera të cënueshme, apo më shumë akses në shërbime. Plani vendos gjithashtu bazat për ndërlidhjen e politikave të barazisë gjinore me procesin e buxhetimit në nivel vendor dhe me instrumentet kombëtare të politikave për barazinë gjinore.

Asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk merr në konsideratë dhe nuk adreson siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve pra të të gjithë anëtareve të komunitetit.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lira/lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj.

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive.

Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave.

Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijnë në mbështetjen në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj. Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes vendore të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikën, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, është gjithashtu edhe çelësi për suksesin tonë ekonomik dhe shoqëror.

II. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Në nenin 18 të Kushtetutës qartësohet shprehimisht se: *"1. Të gjitha/gjithë janë të barabarta/barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkak të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive"*.

Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentesh ndërkombëtare, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zënë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjislacionin vendas, atëherë për zgjidhjen e saj u drejtohem parashikimeve në instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 – 2027 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

a) Instrumente ndërkombëtare

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore (EU Charter for Equality).¹
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPA).
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe Agjenda 2030.
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2021-2025/2027.
- Udhërrëfyesi i BE-së për fuqizimin e grave, publikuar në 7 mars 2025², etj.

b) Kuadri ligjor kombëtar³

- Ligji Nr.9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri" (në proces rishikimi).
- Ligji Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- Ligji Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
- Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.
- Ligji Nr.221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar.
- Ligji Nr.7895, datë 27.01.1995, "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".
- Ligji Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- Ligji Nr. 37/2017 "Kodi i drejtësisë penale për të mitur".
- Ligji Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".
- Ligji Nr. 7905, datë 21.03.1995, "Kodi i procedurës penale", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin".
- Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social".

¹E renditur në krye të kësaj liste për shkak të rëndësisë që ka në nivelin vendor në lidhje me vetë përgatitjen e këtij PVVBGJ. Ndodhëse ky dokument nuk është i ratifikuar nga shteti shqiptar, sepse nuk ka një procedurë të tillë, pjesëmarrja në të bëhet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e vetë bashkive.

²Shih: https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRUE/2025/769542/EPBS_BRUE2025769542_EN.pdf

³Thëksojmë se kjo listë nuk është shtetuese. Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ, mbështeten jo vetëm në këtë kuadër ligjor për barazinë gjinore, por edhe në ligje të veçanta në përputhje me fushën përkatëse të ndërhyrjes.

- Ligji Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit".
- Ligji Nr. 75/2019 "Për rininë", i ndryshuar etj.

c) Politikat kombëtare

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2025 - 2027 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimt që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030.⁴

d) Institucionet përgjegjëse

Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjëse/përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, të cilat/cilët përveçse brenda institucionit të tyre raportojnë, sipas kërkesës, edhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. *Megjithatë, ky Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, nuk është plani i një nëpunëseje/nëpunësi të vetëm, por është një dokument i Bashkisë, për zbatimin me efektivitet të të cilit mban përgjegjësi i gjithë stafi i bashkisë dhe njësive administrative, në bashkëpunim dhe me të gjithë institucionet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në këtë drejtim.*

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe *Aleanca e Grave Këshilltare dhe Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale*⁵ në nivel të Këshillit Bashkiak.

III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2025 - 2027 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

⁴ Miratuar me VKM nr.400, datë 30.06.2021. Shiko: <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>

⁵ I përbërë nga pesë anëtarë dhe anëtarë, 2 gra dhe 3 burra. Shiko: <https://bulloza.gov.al/ep-content/uploads/2024/04/komisionet2024.pdf>

- **Ngritja e Grupit të Punës.** Grupi i Punës për hartimin e këtij PVVBGJ u ngrit me Urdhër të Kryetarit Nr.200, Datë 05.05.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Planit Vendor të Veprimet për Barazinë Gjinore 2025 – 2027 dhe Planit Social Vendor 2025-2028". Në përbërje të këtij grupi ishin 11 anëtare/anëtarë, nga të cilat/cilët 5 burra dhe 6 gra.
- **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk review).** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentesh ekzistues apo draft dokumentesh të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore.
- **Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PVVBGJ 2025-2027.** Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan nga identifikimi i prioriteteve bazuar në desk review, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë.
- **Konsultimet paraprake brenda bashkisë.** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësues dhe përfaqësues nga të gjitha drejtoritë në bashki), si dhe administratorët e NJA-ve. Gjithashtu këto diskutime e lehtësuan mjaft procesin e përgatitjes së draftit të parë të PVVBGJ-së, pasi u ndalën në çështjet kryesore për t'u adresuar përmes përgatitjes së draftit të parë të PVVBGJ-së, pasi u ndalën në çështjet kryesore për t'u adresuar përmes përgatitjes dhe zbatimit të këtij PVVBGJ.
- **Konsultim me një grup të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh.** Grupi i Punës mendoi që në takimin e tretë të tij të ftohej edhe një rreth të ngushtë partnerësh e bashkëpunëtorësh, për të diskutuar parimisht mbi përmbajtjen e PVVBGJ. Ky takim rezultoi shumë i suksesshëm, me diskutime e propozime konkrete nga të ftuarat/ftuarit.
- **Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2025 - 2027.** Drafti matrica e përgatitur për konsultim përmbante masat dhe veprimet e parashikuara të përfshira në pesë fusha ndërhyrjeje, ku katër të parat bazoheshin në fushat prioritare të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030 (pra fuqizimi ekonomik, pjesëmarrja në vendimmarrjen politike e publike, dhuna me bazë gjinore dhe integrimi gjinor në nivelin vendor), si dhe një fushë e pestë me masa të ndryshme të propozuara, të cilat pas konsultimeve do të saktësoheshin nëse do të rrinin në një fushë të veçantë apo do bashkoheshin me fushat më sipër. Në këtë draft u reflektuan edhe ndryshimet e dakortësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.

- *Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit.* Ky proces u zhvillua mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultime u përfshinë drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, NJA-ve, si dhe anëtare të Këshillit Bashkiak me date 25 Gusht 2025.
- *Kostimi i draft PVVBGJ 2025-2027.* Pas finalizimit të matricës së aktiviteteve dhe qartësimit të tyre me çdo drejtori, paralelisht u realizua edhe kostimi i aktiviteteve të dakortësuar.
- *Miratimi i PVVBGJ 2025 – 2027 në Këshillin Bashkiak.* Versioni përfundimtar i PVVBGJ i konsultuar e kostuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak. Pas miratimit, PVVBGJ 2025 – 2027 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë.

IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Vizioni: "Gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Fushë-Arrëzit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantes/emigrantit e azilkërkuess/azilkërkuessit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës".

Parimet⁶ që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, siç paraqiten në vijim:

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre, përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëllojshme.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, në vendimmarrje, është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

Fushat kryesore të ndërhyrjes

PVVBGJ 2025 - 2027 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV). Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.

⁶ Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://www.ccre.org/imgs/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

- II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.
- III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.
- IV. Integrimi gjinor në politikat vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifikë, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore.

Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparencja e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

Rezultatet e pritshme, objektivat specifikë dhe treguesit

Fusha e ndërhyrjes:	
I.	Promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denjë, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre.
Rezultatet e pritshme:	
I.a.	Veprimet e bashkisë për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm.
I.b.	Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.
Objektivat specifikë:	
I.1.	Rritja e aksesit të grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, ndaj shërbimeve, produkteve dhe burimeve financiare që ndikojnë në fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e situatës ekonomike të tyre.
Treguesit në nivel objektiv specifik:	

I.1.a. Numri i grave dhe të rejave përfituese nga aktivitetet e fuqizimit të kapaciteteve (trajnime dhe programe të formimit profesional), ndarë sipas moshës, përkatësisë etnike-kulturore, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, llojit të aftësive të përfituara (llojit të trajnimit), etj. I.1.b. Numri i sipërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të reja, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.).
Fusha e ndërhyrjes: II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe të rejave e të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, në vendimmarrjen politike apo publike në nivelin vendor.
Rezultatet e pritshme: II.a. Aktivitetet dedikuar pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në vendimmarrjen politike apo publike, adresojnë në mënyrën e duhur sfidat dhe stereotipet gjinore ekzistuese. II.b. Veprimet që ndërmerr bashkia në këtë drejtim, nxitin zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe parimet e barazisë e gjithëpërfshirjes, veçanërisht për grupet më pak të përfaqësuara.
Objektivat specifikë: II.1. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të reja, në të gjithë diversitetin e tyre.
Treguesit në nivel objektiv specifik: II.1.a. Numri i të rejave dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, që kanë përfunduar trajnime për zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe për integrimin gjinor në vendimmarrje. II.1.b. Përqindja e grave dhe të rejave drejtuese, në të gjithë diversitetin e tyre, në strukturat vendimmarrëse në Bashki, Këshillin Bashkiak, Njësitë Administrative, Këshillat e Fshatrave, etj.
Fusha e ndërhyrjes: III. Liri nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje.
Rezultatet e pritshme: III.a. Mekanizmi i Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, i fuqizuar dhe efikas. III.b. Një brez i ri i barazisë, që lufton stereotipet gjinore, praktikatat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë, i krijuar dhe fuqizuar. III.c. Veprimet e bashkisë për ndërtimin e komuniteteve të sigurt, të paqta e gjithëpërfshirëse, të përmirësuara ndjeshëm.
Objektivat specifikë:

- III.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit kundër dhunës në familje.
- III.2. Zvogëlimi i steriotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëllojshëm, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.
- III.3. Fuqizimi i grave, të rejave dhe të rinjve, për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, përmes promovimit të Agjendës "Gruaja, Paqja dhe Siguria" dhe Agjendës "Rinia, Paqja dhe Siguria".

Treguesit në nivel objektiv specifik:

- III.1.a. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuar dhe të trajtuara nga MKR, krahasuar me numrin total të rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga Bashkia.
- III.1.b. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- III.2.a. Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere të organizuara nga bashkia për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- III.3.a. Përqindja e grave, burrave, të rejave dhe të rinjve të përfshira/përfshirë në aktivitete që synojnë paqen, sigurinë dhe ndërtimin e komuniteteve të sigurta e gjithëpërfshirëse.

Fusha e ndërhyrjes:

IV. Integrimi Gjinor në Politikat Vendore.

Rezultatet e pritshme:

- IV.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.
- IV.b. Buxhetimi i përgjithshëm gjinor i zbatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe integrimi gjinor i reflektuar në politikën dhe planin e bashkisë.

Objektivat specifikë:

- IV.1. Rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së bashkisë në përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore.
- IV.2. Zbatimi i detyrimeve për integrimin gjinor dhe buxhetimin e përgjithshëm gjinor në nivel vendor.

Treguesit në nivel objektiv specifik:

- IV.1.a. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore.
- IV.2.a. Numri i programeve buxhetore të analizuara nën këndvështrimin gjinor.
- IV.2.b. Përqindja e buxhetit vjetor të bashkisë e dedikuar për zbatimin e PVVBGJ dhe norma vjetore e rritjes së tij, krahasuar me përqindjen e buxhetit të shpenzuar për këtë qëllim.

Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë fushë të ndërhyrjes synojnë përmirësimin e nivelit të sigurisë në hapësirat publike përmes koordinimit të veprimeve ndërmjet të gjithë aktorëve dhe mekanizmave përgjegjës të ngritur tashmë për këtë qëllim, si dhe rritjen e efektivitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore. Informimi dhe edukimi për të njohur më mirë të drejtat dhe mbrojtjen që ofrohet, do të shoqërohet dhe me shërbime të specializuara të cilat ofrohen sipas standardeve por edhe që mbështeten me shumë financiarisht nga bashkia. Po kështu gjetja e zgjidhjeve për të mundësuar riintegrimin e viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje e të dhunës me bazë gjinore, do të jetë një tjetër drejtim në të cilin do të punohet gjatë këtyre viteve.

KOSTO PËR ZBATIMIN E PVVBGJ 2025 - 2027

Të gjitha aktivitetet e parashikuara në matricën e PVVBGJ 2025 – 2027 (bashkangjitur) shoqërohen edhe me një kosto financiare të domosdoshme për zbatimin e tyre, e cila zbërthehet më tej në kosto që mbulohet nga vetë Bashkia, kosto që mbulohet nga donatorët dhe palët e treta, si dhe kosto që ka nevojë për t'u siguruar (apo hendeku financiar).

Është e rëndësishme të theksohet se një pjesë të mirë të aktiviteteve Bashkia e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra specialisteve / specialistëve, të cilat / cilët aktualisht marrin një page fikse, sallave / ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike të cilat blihen në total për të gjithë institucionin), etj. – *pra që nuk ka nevojë për kosto shtesë pasi këto kosto parashikohen në mënyrë të përvitshme.* Megjithatë, në këtë Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore 2025 - 2027 evidentohet edhe vlera përkatëse e këtij kontributi, me qëllim që gjatë monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të tij, të mundësohet vlerësimi edhe përmes kosto-eficencës.

Gjithashtu, është e rëndësishme të mbahet në konsideratë fakti që këto përlogaritje janë bërë për minimumin e vlerave që do të kërkonte organizimi i aktiviteteve të propozuara.

Në seksionin VI "Matrica e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2027", për çdo masë/aktivitet të parashikuar, në kolonën e koston jepet informacion për:

- a. **Vlerën totale të koston të zhvillimit të masës/aktivitetit.** Kjo kosto është përlogaritur si kosto bazë (pra me zërat që përmban zbatimi i aktivitetit), e shumëzuar me numrin e aktiviteteve të parashikuara për zbatim për të gjithë kohëzgjatjen e zbatimit të PVVBGJ.
- b. **Vlerën e koston që mbulohet nga Bashkia.** Këtu duhet pasur parasysh se kjo vlerë jo domosdoshmërisht është shtesë në buxhetin e bashkisë, ajo mund të jetë edhe në formën e angazhimit të pjesshëm të specialisteve/specialistëve të drejtorive përkatëse (pra disa ditë

pune ia kushtojnë zbatimit të masës/aktivitetit, brenda pagës mujore që kanë), ose në formën e kontributit "në natyrë (in kind)" përmes vënies në dispozicion të sallave e ambienteve, etj. Po kështu, në ato raste kur masa apo veprimi është i parashikuar si detyrim parësor në një tjetër plan veprimi, në lidhje me kostot, është cituar referenca në planin përkatës, për të shmangur kështu mbivendosjet në përlogaritjet financiare.

- c. **Vlerën e kostos që mbulohet nga donatorët.** Kjo nënkupton që për zhvillimin e masës/aktivitetit ka një dakortësi paraprake me donatorët mbi kontributin e tyre. Në këtë rast, janë përlogaritur si të mbuluara, vetëm kostot për ato aktivitete që ka pasur një dakortësi / marrëveshje mes bashkisë dhe donatorit, në momentin e përgatitjes së këtij PVVBGJ. Paralelisht, bashkia do vijojë punën për identifikimin e donatorëve të ndryshëm dhe shtimin e mbështetjes nga ana e tyre, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij PVVBGJ.
- d. **Hendeku financiar.** Ky ka të bëjë me vlerën e kostos të pa mbuluar nga asnjë burim në momentin e miratimit të këtij plani. Kjo vlerë mund të mbulohet përmes negocimit me donatorët, bizneset, OJF të specializuara, etj., ose mund edhe të parashikohet brenda Planeve Buxhetore Afatmesme (PBA) e buxheteve vjetore, duke filluar nga PBA 2026-2028.

VI. RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Procesi i raportimit për aktivitetet e zbatuara do të kryhet nga Sektori përgjegjës për zbatimin e aktivitetit tek Komisioni për Barazinë Gjinore në nivel të Bashkisë.

Menjëherë pas miratimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025 - 2027, si hap i parë i zbatimit të tij, do të hartohen fletët e treguesve me informacionin që duhet të mbledhet dhe raportohet në bazë aktiviteti, por edhe në bazë të objektivave specifike.

Raportimet mbi aktivitetet do të jenë periodike (çdo 3 muaj) ose në bazë të kërkesës së Komisionit për Barazinë Gjinore në nivel bashkie, apo Kabinetit të Kryetarit.

Raportimet në bazë të objektivave specifike do të përgatiten dy herë në vit (çdo 6 muaj).

Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor të Veprimit në nivel të objektivave do të kryhet nga Komisioni për Barazinë Gjinore në nivel të Këshillit Bashkiak. Raportet e përgatitura do të përcillen edhe tek Aleanca e Grave Këshilltare dhe sipas nevojës/kërkesës edhe në MSHMS, apo në Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore. Bazuar në monitorimin e kryer, PVVBGJ duhet të rishikohet dhe përmirësohet në mënyrë periodike dhe të paktën çdo një vit nga data e fillimit të zbatimit të tij.

Eufha e ndërrmjes		NË VËNDIMIMIN POLITIKË APO PUBLIKE NË NIVELIN VENDOR			
1	TRITJA E PËRSHKËRSES DHE PËRFAJESIMIT TË GRAVE DHE TË REJAVE DHE TË MINIVË, NËTË GJITHË DIVERTETIN E TYRE.				
(Objektiv strategjik)	NË VËNDIMIMIN POLITIKË APO PUBLIKE NË NIVELIN VENDOR.				
Rezultatet e pritshme	1 Aktivitetet e dedikuara pjesëmarrjes dhe përfaqësimit në vendimmarrjen politike apo publike, adresojnë në mënyrën e duhur shtat dhe shprehjet gjinore eksistuese. 1 Vlerimet që ndërmarr bashkë në kërkim, rritin shatimin e legjislacionit në fuqi dhe parimet e barazisë e gjithëpërfshirjes, vëcanisht për grupet më pak të përfaqësuara.				
Dokumentat kryesore që is referohemi:	Karta Europiane për Baraz të grave dhe burrave në jetën vendore - nenet 2 dhe 3. Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe nenet 7 dhe 8. Deklarata dhe Platforma për Vlerim e Pësimin (SODIA) - fusha kritike 7. Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës ndaj Familje (Konventa e Stambollit) - eni 4/3. Plani i Veprimt për Baraz të Gjinore (BEU GAP III) - shtylla 1 dhe 5, fusha kryesore tematike 3, 3.3, 6. Strategjia Kombëtare për Baraz të Gjinore (SKBGJ) 2021-2030 fusha e ndërrmjes II, objektivin specifik II.3.				
Objektiv specifik	II.1. Rritja e pjesëmarrjes në vendimmarrjen politike e publike në nivelin vendor, për gratë dhe të reja, në të gjithë diversitetin e tyre. II.1.a. Numri i të reja dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, që kanë përfunduar trajtimet për shatimin e aftësive udhëheqëse dhe për integrimin gjinor në vendimmarrje. II.1.b. Përqindja e grave dhe të reja, në të gjithë diversitetin e tyre, në strukturat vendimmarrëse në Bashki, Këshillin Bashkia, Njësitë Administrative dhe në Këshillin e Përbashkët.				
	TRITJES:	Baselines: 2025	Target: 2027	MONITORING	
	Do të përcaktohet	Rritur me 4% (2% përqindje)	Komiteti për Baraz të Gjinore në nivel bashkie (Grupi i Monitorimit të PVBGJ)		
	Do të përcaktohet	Rritur në përputhje me legjislacionin në fuqi	Komiteti i Baraz të Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, si dhe anëtarët anëtarë të Këshillit Bashkia		

MASAT DHE AKTIVITETET	PRËRATËSIT	ZBATIMI	AFATI KUROR	TREGUESI	KOSTOJESHE		
					2025	2026	2027
II.1.1. Takime motivuese për ngritjen e përkrahjes së grave dhe të reja në vendimmarrje të organizuara me pranim të vetë grave dhe të reja që janë aktualisht në pozicione vendimmarrëse.	Sektori i Kujdesit Social	Njësitë Administrative, Komisioni për Barazim Gjinor, DIF, organizatat ndërkombëtare	2025	2 takime në vit	7 200 (bashkë)	7 200 (bashkë)	7 200 (bashkë)
			2027	Numri i grave dhe të reja të përfshira në çdo takim, ndarë sipas modit, vendbanimit, etj.			
II.1.2. Trajtim i Aleancës së Grave Këshilltare (AGK) dhe Komisionit të Barazit Gjinor (KGG) në lidhje me përfshirjen, lidhshmërinë, vendimmarrjen dhe barazim gjinor.	Sektori i Kujdesit Social	Njësitë Administrative, KGG, DIF, organizatat ndërkombëtare	2025	1 trajtim në vit	85 000 (donatore)	85 000 (donatore)	85 000 (donatore)
			2027	Numri i të trajnuarave, ndarë sipas pozitës, etj.			
II.1.3. Përmirësim i rregullimeve për fuqizimin e Këshillit Vendi Rindor duke i dhuruar në antarësimin e tyre dhe të rinjve etj. grupet e pa favorizuara, si dhe duke respektuar barazim gjinor.	Sektori i Arsimi dhe Sporteve	Këshilli i Kryetarit	2026	Rregullorja e përmirësuar	N/A	32 500 (20 000 leke bashkë dhe 12 500 donatore)	32 500 (20 000 leke bashkë dhe 12 500 donatore)
			2027	Numri i antarëve / antarëve të aktuar në KVI sipas parimeve të KVI dhe gjithëpërfshirjes.			
III.1.4. Trajtime të reja dhe të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre, për furnizimin e aftësive udhëheqëse dhe drejtuese, si dhe adresimin në mënyrën e duhur të barazit gjinor në vendimmarrje.	Sektori i Arsimi dhe Sporteve	DIF, organizatat ndërkombëtare	2025	1 trajtim në vit	32 500 (20 000 bashkë)	30 000 (20 000 bashkë)	30 000 (20 000 bashkë)
			2027	Numri i të reja dhe të rinjve të përfshirur, ndarë sipas seksit, mosës, etj.			
III.1.5. Përfshirja e vazhdueshme e të rinjve në procesin vendimmarrës të politikave rinore, sociale, të barazit gjinor, fuqizimit ekonomik, zhvillimit urban e mjedisor dhe në çdo politikë tjetër të rëndësishme që harton bashkia.	Sektori i Arsimi dhe Sporteve	Të gjitha drejtoritë që hartojnë strategji, plane, politika në fushat përkatëse	2025	Të paktën 1 takim në vit	12 400 (10 000 bashkë)	12 400 (10 000 bashkë)	12 400 (10 000 bashkë)
			2027	Numri i të reja dhe të rinjve të përfshirur, ndarë sipas seksit, mosës, etj.			

II.1.5. Takime për inkurajimin e të rejave dhe grave për t'u përfshirë dhe t'arritur në pozitën e Kryetarës së Fshatit.	Sektor i kujdesit Social	AGM, Sektor i Arsimit dhe Sporteve, OJF, organizatat ndërkombëtare.	2025 2027	6 takime gjithsej Numri i pjesëmarrësve, ndarë sipas modit, fshatit, etj.	14000 bushë	14000 bushë	14000 bushë
II.1.7. Zbulimi i parimeve të barazisë gjinore në emërimet që bien boshkë në pozicionet drejtuese (veçanërisht Administratore/Administratore të NUA)	Sektor i Burimeve i Burimeve njësore	Kabineti i Kryetarit/ Kryetarit	2027	Numri i grave dhe burave që emërohen në çdo pozitë drejtuese	N/a 152 burra 112 gra	N/a	Kosto e përfaqësuesve përfaqësues për emërimet
II.1.8. Aktivitetet e sensibilizimit të komunitetit dhe të tjerëve në politikë dhe vendimarrje.	Sektor i kujdesit Social	AGM, XBGJ, OJF, organizatat ndërkombëtare	2025 2027	1 aktivitet në vit Numri i pjesëmarrësve, ndarë sipas modit, fshatit, etj.	12 500 (bushë)	12 500 (bushë)	12 500 (bushë)